



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 15549 Prot.

Lezhë, më 31 . 08 .2020

VENDIM

Nr. 119 Datë 26 . 08 . 2020

Për

Ndryshimin e Vendimit Nr. 86 datë 25.06.2020, në pikën 1 shkronja B, ana ndërtimore dhe pika 3, për akordimin e ndihmës financiare për dëmin e shkaktuar nga rënia e zjarrit në banesën e shtetasit Dorian Gjergj Palokaj, banor në fshatin Balldre, Njësia Administrative Balldre, Bashkia Lezhë.

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ligjit nr. 8756, dt. 26.03.2001 "Për Emergjencat Civile", të VKM nr.329, dt.16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Sektori i Emergjencave Civile dhe Menaxhimit të Krizave, mbi dëmin e shkaktuar në banesën e Z.Dorian Gjergj Palokaj, banor në fshatin Balldre, Njësia Administrative Balldre, Bashkia Lezhe, pas diskutimit të anëtareve, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

Vendosi:

I. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Lezhë për mbështetje financiare të shtetasit Z.Dorian Gjergj Palokaj për dëmtimin e banesës se tij nga rënia e zjarrit.

A. Të miratojë dëmin e shkaktuar nga rënia e zjarrit në vlerën **158566 lekë.**

a) Dëmi i shkaktuar në ndërtesë **105566 lekë.**

b) Dëmi i shkaktuar në orendi, mobilje e pajisje **53000 lekë.**

B. Mbështetur në VKM. nr. 329 dt.16.05.2012, kap 3, pika 3, gërma "b" dhe "ç", Kompensimi për dëmin e shkaktuar në anën ndërtimore të jetë në masën 50%, ndërsa Kompensimi për dëmin e shkaktuar në orendi, mobilje e pajisje, mbështetur në kap 3, pika 3 gërma d të VKM-së së mësipërme të jetë sa masa e dëmit të shkaktuar dhe konkretisht :

a) Vlera e kompensimit të dëmit në anën ndërtimore të jetë **52783 lekë.**

b) Vlera e kompensimit të dëmit në orendi, mobilje e pajisje **53000 lekë.**

Vlera totale **105783 lekë.**

2. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Lezhë.

3. Bashkia Lezhë t'i akordojë familjes së shtetasit Z.Dorian Gjergj Palokaj, ndihmën emergjente në vlerën prej 105783 lekë nga buxheti i Bashkisë Lezhë, fondi i Emergjencave Civile i destinuar dhe i miratuar nga Këshilli i Bashkisë për vitin 2020, bazuar në VKM nr.329 dt.16.05.2012 për Emergjencat Civile.

4. Ndihma financiare që do t'i akordohet do të përdoret për t'i ardhur në ndihmë familjes së shtetasit Z.Dorian Gjergj Palokaj, banesa e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI**  
**FLORIDA ÇUNAJ**



**KRYETARI**  
**ERNEST RAKAJ**

